

## Realizimi i Investimeve për periudhën 2013-2016

Realizimi i investimeve për objektet e financuara me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve për periudhat 2013-2014, 2014 - 2015 dhe 2015-2016 në DARQ Tiranë janë si më poshtë:

Për periudhën **2013-2014** kemi investime dhe ndërhyrje në objektet:

**1-Rikonstruktion +shtesë në shkollën e Mesme të Bashkuar Surrel në Nj. Administrative Dajt**

Vlera e kontratës është **15 320 482** lekë me TVSH.



**2-Ndërtim shkolla 9vjeçare Bastar Murriz në Nj. Administrative Zallbastar**

Nga dokumentacioni i objektit kontrata e lidhur me firmën sipërmarrëse është **14 987 238** lekë me TVSH. Fakti është që dhe sot ky objekt nuk është në funksion për arsye që njësia administrative i ka parashtruar në Bashkinë Tiranë.



**3-Ndërtim mur rrethues e sistemim i jashtëm në Sh. M. B. “Sadi Nuri” dhe Shkollën 9-vjeçare “Bashkim Berisha” në Nj. Administrative Ndroq. Fondi i akorduar dhe realizuar është 8 549 592 lekë.**



**4-Ndërtim palestre, sistem ngrohje dhe rrethim për Shkollat e mesme dhe 9 vjeçare Katundi Ri. Ky është një objekt i filluar në 2012 dhe me investim në dy vite me fond gjithsej 34 270 193 lekë.**



Për periudhën **2014-2015** të gjitha objektet e financuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve janë me punime në vazhdim me financime në dy vite. Ne si qark kemi tre objekte si:

**1-Rikonstruksion i Shkollës së Mesme “Sadi Nuri” Ndroq, Nj. Administrative Ndroq.U realizua një rikonstruksion total i objektit me punime cilësorë dhe me një investim prej 23 643 197 lekësh.**



**2-Shtesë dy kate në Shkollën 9 vjeçare Qesarake, Nj. Administrative Dajt ku në objektin e ri te ndërtuar në 2011 u shtuan dy kate dhe objekti është pesë katësh, i punuar me cilësi. Vlera e kontratës është 46 699 592 lekë.**



**3-Rikonstrukcion dhe shtesë në Shkollën e Mesme të Bashkuar Vaqarr, në Nj. Administrative Vaqarr, objekt me vlerë kontrate 31 801 747 lekë.**



Për periudhën **2015-2016** nuk kemi financime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve si dhe as kërkesa dhe projekte nga Bashkia e Tiranës për objektet e arsimit parauniversitar për qarkun Tiranë.

*Specialiste në S.P.ZH*

*Ing. Syme KOÇI*